



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.207/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega në Mitrovica e Jugut, parashtruar kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Guxo, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovica e Jugut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa ZL.Anr.207/2025, e datës 10.10.2025, parashtruar nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega në Mitrovica e Jugut, parashtruar kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Guxo, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovica e Jugut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 10.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega në Mitrovica e Jugut, e cila është parashtruar-dorëzuar në Postën e Kosovës me datën 10.10.2025, në të cilën pretendohet se me datë 10.10.2025 që nga orët e hershme të mëngjesit kane hasur ne kombibus afër objektit te palestra e sporteve “Minatori” ku ishte parapare të mbahet tubimi përmbyllës i PDK-se ne Mitrovicë. Parashtruesi i ankesës thekson se kombibusi në fjalë është vendosur pas publikimit të njoftimit për mbajtjen e tubimit nga PDK dhe në kombibus janë vendosur fotot e kandidatit nga radhët e subjektit politik LVV-Guxo Faton Peci dhe kandidatit për asamble Shkëlzen Haliti. Sipas parashtruesit të ankesës me veprimet e tilla konsiderohet që provokojnë situata te cilat nuk i duhet procesit elektoral dhe bien ndesh me Rregullën 07/2024 neni 8 dhe 7 pika 5 dhe 2.4. Si dëshmi kane bashkangjitur një foto.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik LVV thekson se ankesa në fjalë është e pabazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë ligjor. Fotografia e bashkëngjitur nuk përbën provë të mjaftueshme për të dëshmuar ndonjë veprim në kundërshtim me rregullat zgjedhore. Ajo nuk përmban asnjë element që vërteton kohën e saktë të realizimit, rrethanat e saj apo ekzistencën e ndonjë aktiviteti zgjedhor në momentin e paraqitur. Një fotografi e thjeshtë e një automjeti të parkuar në një hapësirë publike nuk mund të përdoret si bazë për të konstatuar shkelje të dispozitave zgjedhore, aq më tepër kur mungon çdo raport nga organet zyrtare të mbikëqyrjes. Edhe sikur fotografia të merrej si e saktë, asnjë nga nenet e cituara nuk ndalon apo sanksionon një situatë të tillë. Neni 8 i Rregullores 07/2024 rregullon veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore, duke ndaluar mbajtjen e tubimeve, shpërndarjen e materialeve zgjedhore apo përdorimin e mjeteve të komunikimit për të ndikuar tek votuesit në ditën e zgjedhjeve. Në rastin konkret nuk ekziston asnjë element që të tregojë një veprim të tillë. Po ashtu, neni 7.2.4 i së njëjtës rregullore ndalon vendosjen e materialeve të fushatës brenda institucioneve publike, shkollave, objekteve fetare apo në një distancë më pak se njëqind metra nga qendrat e votimit. Hapësira ku është parkuar automjeti është një hapësirë publike, e lirë, jo institucionale, e cila nuk kufizohet nga asnjë prej ndalesave të përcaktuara në këtë nen. Prandaj, parkimi në një vend të tillë nuk mund të interpretohet si shkelje e dispozitave të fushatës zgjedhore. Në të njëjtën mënyrë, neni 7.5 i Rregullores 07/2024 ndalon përdorimin e resurseve publike për qëllime elektorale, duke nënkuptuar mjetet apo pronën e institucioneve shtetërore. Nuk ka asnjë fakt që sugjeron se në këtë rast është përdorur ndonjë resurs publik. Parkimi i një automjeti në një hapësirë të hapur dhe të përbashkët për qytetarët nuk është akt i privilegjuar dhe as përfitim nga ndonjë burim shtetëror. Duhet theksuar se parkimi i një veture në hapësirë publike, edhe atëherë kur bart mesazh elektorale, kur mungon çfarëdo ndërveprimi me ndonjë aktivitet politik të subjektit ankues nuk përbën provokim, pengesë apo ndërhyrje në aktivitetin e tyre. Në bazë të parimit të përgjegjësisë provuese, barra e provës i takon ankuesit. Në këtë rast nuk ekziston asnjë element që ta lidhë fotografinë me ndonjë shkelje konkrete të Rregullores 07/2024. Prandaj, kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të hedhë poshtë ankesën si të palejuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoj se pretendimet në ankesë nga subjekti politik PDK, se ka hasur një kombibus afër objektit të palestra e sportive “Minatori” ku ishte paraparë të mbahet tubimi përmbyllës i PDK-se në Mitrovicë dhe se në kombibus ishin të vendosura fotot e kandidatit nga radhët e subjektit politik LVV-Guxo Faton Peci dhe kandidatit për asamble Shkëlzen Haliti, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 7 dhe 8 të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilën janë përcaktuar rregullat për fushatës zgjedhore, pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkëngjitur asnjë provë si dëshmi me të cilën do të vërtetohej se ngjarja me të cilën pretendohet të ketë ndodhë në objekt publik apo se e njëjta e ka penguar mbajtjen e tubimit të subjektit politik PDK. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë

parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.207/2025 më datën 15.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.